



UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS  
KOMISIONI INSTITUCIONAL I ZGJEDHJEVE

Prot. 1925 Nr.

Durrës, më 4 / 7 / 2023

**V E N D I M**  
Nr. 20, datë 4 / 7 / 2023

**"PËR HAPJEN E PROCESIT TË APLIKIMEVE PËR ANËTAR TË KOMISIONIT TË PËRHERSHËM PËR MBARËVAJTJEN E VEPRIMTARISË DHE MARRËDHËNIEVE ME STUDENTËT, NË UNIVERSITETIN "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS"**

Në mbështetje të ligjit, Nr. 80/2015, datë 17/09/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" Neni 46 "Komisionet e përhershme", Neni 23 pika 5 e Statutit të Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës, Relacionit Nr. 1058 Prot, datë 21.06.2023 "Mbi ngritjen e Komisionit të Përhershëm në nivel Institucional, për Mbarëvajtjen e Veprimtarisë dhe Marrëdhënieve me Studentët në UAMD", të Rregullores "Për organizimin e zgjedhjeve për Autoritetet dhe Organet Drejtuese në Universitetin "Aleksandër Moisiu" Durrës", e miratuar me vendim Senati Akademik Nr.43, datë 11.02.2020, Urdhërit të Rektorit Nr.265, datë 4.7.2023 "Për shpalljen e zgjedhjeve për anëtar të Komisionit të Përhershëm për Mbarëvajtjen e Veprimtarisë dhe Marrëdhënieve me Studentët në Universitetin "Aleksandër Moisiu", Durrës", Komisioni Institucional i Zgjedhjeve,

**VENDOSI:**

1. Hapjen e procesit të aplikimeve për anëtar të Komisionit të Përhershëm për Mbarëvajtjen e Veprimtarisë dhe Marrëdhënieve me Studentët, në Universitetin "Aleksandër Moisiu", Durrës".
2. Regjistrimi i kandidatëve do të zhvillohet nga data **10.07.2023** deri në datën **17.07.2023**.
3. Dorëzimi i dokumentacionit të bëhet me anë të postës elektronike në formatin pdf. Në adresën e email: ballgjinjuana@yahoo.com
4. Bashkëlidhur vendimit dokumentacioni i cili do të dorëzohet për aplikim.
5. Data e zhvillimit të zgjedhjeve do të jetë **04.09.2023**.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**ZV/KRYETAR**

**Gentian RUSPI**





UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS  
KOMISIONI INSTITUCIONAL I ZGJEDHJEVE

KËRKESË PËR KANDIDIM

PËR ANËTAR TË KOMISIONIT TË PËRHERSHËM PËR MBARËVAJTJEN E  
VEPRIMTARISË DHE MARRËDHËNIEVE ME STUDENTËT, NË UNIVERSITETIN  
"ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS"

Unë i/e nënshkruar/a \_\_\_\_\_, lindur më \_\_\_ / \_\_\_ / \_\_\_\_, në  
\_\_\_\_\_, të rrethit \_\_\_\_\_, gjinia \_\_\_\_\_, staf akademik në  
Departamentin \_\_\_\_\_, Fakulteti \_\_\_\_\_ paraqes kërkesën time për të  
kandiduar si anëtar i Komisionit të Përhershëm për Mbarëvajtjen e Veprimtarisë dhe  
Marrëdhënieve me Studentët, në Universitetin "Aleksandër Moisiu" Durrës.

Deklaroj nën përgjegjësinë time personale se:

- Nuk jam dënuar asnjëherë gjatë jetës time, me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë vepër penale.
- Nuk kam asnjë shkak për të qenë objekt i ligjit nr, 136/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike"
- Nuk kam asnjë shkak për të qenë objekt i ligjit 45/2015 "Për të drejtën e informimit për dokumentat e ish-sigurimit të shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë.
- Nuk është caktuar ndaj meje asnjë nga masat e sigurimit personal
- Nuk është dhënë ndaj meje asnjë mase disiplinore e cila është në fuqi

Kësaj kërkesë i bashkangjitet, kopja e kartës së identitetit/pasaportës, kopja e noterizuar e titullit \_\_\_\_\_ që unë zotëroj, vërtetimi i qendrës time të punës, vetëdeklarimi për integritetin e lartë akademik, vetëdeklarimi gjendjes gjyqësore.

Për sa deklarova në këtë kërkesë mbaj përgjegjësi personale dhe autorizoj Komisionin Institucional të Zgjedhjeve të bëjë verifikimet që ai i konsideron të nevojshme.

Aplikuesi

\_\_\_\_\_



---

UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS  
KOMISIONI INSTITUCIONAL I ZGJEDHJEVE

Dokumentacioni për kandidim:

- a) Kërkesën për kandidim, e cila përmban, emrin; atësinë; mbiemrin; datëlindjen; gjininë; shprehjen e vullnetit për kandidim;
- b) Vetëdeklarim për integritetin e lartë akademik të kandidatit
- c) Deklarimin që nuk është i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra penale;
- d) Deklarimin se nuk ka shkak për të qenë objekt i ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" dhe ligjit nr. 45/2015 "Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-sigurimit të shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë";
- e) Kopje të dokumentit të identifikimit;
- f) Kopje të noterizuar të titullit akademik, gradës shkencor edhe diplomës/diplomave të arsimit të lartë;
- g) Fotokopje të noteruar të librezës së punës.(Vërtetimi i punës)





UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS  
KOMISIONI INSTITUCIONAL I ZGJEDHJEVE

KËRKESË PËR KANDIDIM

PËR ANËTAR TË KOMISIONIT TË PËRHERSHËM PËR MBARËVAJTJEN E  
VEPRIMTARISË DHE MARRËDHËNIEVE ME STUDENTËT, NË UNIVERSITETIN  
"ALEKSANDËR MOISIU", DURRËS

(PËRFAQËSUES STUDENT)

Unë i/e nënshkruar/a \_\_\_\_\_, lindur më \_\_\_/\_\_\_/\_\_\_, në \_\_\_\_\_, të rrethit \_\_\_\_\_, gjinia \_\_\_\_\_, student në Programin e Studimit \_\_\_\_\_ të Fakultetit \_\_\_\_\_, paraqes kërkesën time për të kandiduar për anëtar i Komisionit të Përhershëm për Mbarëvajtjen e Veprimtarisë dhe Marrëdhënieve me Studentët, në Universitetin "Aleksandër Moisiu" Durrës, për zgjedhjet e datës 04.09.2023, si përfaqësues i Studentëve, në përputhje me Rregulloren "Për organizimin e zgjedhjeve për Autoritetet dhe Organet Drejtuese në Universitetin "Aleksandër Moisiu" Durrës" e miratuar me vendim Senatit Akademik nr.43, datë 11.02.2020.

Kësaj kërkesë i bashkangjitet, kopja e kartës së identitetit/pasaportës, vërtetimi që jam student si dhe lista me emrat, matrikullin dhe firmat e 30 studentëve që mbështesin kandidaturën time.

Për sa deklarova në këtë kërkesë mbaj përgjegjësi personale dhe autorizoj Komisionin Institucional të Zgjedhjeve të bëjë verifikimet që ai i konsideron të nevojshme.

Aplikuesi

\_\_\_\_\_